



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.11, datë 28.12.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:  
“GODINË SHËRBIMI HOTELIER ME 6 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË”,  
ME VENDNDODHJE NË CURRILA, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të nenit 113, 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “DCI Company” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë shërbimi hotelier me 6 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Currila, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “DCI Company” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Durrës, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MËJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURKHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

